

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Paraqes një ankesë kundër:

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS Zyra e Prokurimit

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	328-25-10983-5-5-8
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: “Furnizim me Inventar per Salla te gjykimeve dhe Zyra te Shkrimoreve per Gjykata dhe KGJK”

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“MOBELLAND” SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga “Xhavit Sylja” p.n.

(Adresa)

(Vendi): Suharekë

(Kodi postar): 23 000

049 606 379

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it) /

Ardian Morina

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@mobelland.net

(Adresa elektronike)

09.04.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Të nderuar, sikur jeni në dijeni, ne kemi konkurruar në tenderin me titull: **“Furnizim me Inventar për Salla të gjyqimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe KGjK”** dhe nr. të Prokurimit: **328-25-10983-5-5-8** të shpallur me datë **05.12.2025**, afati i fundit për dorëzimin e tenderit ka qenë me datë **15.12.2025** deri në ora **14:00**. Hapja e tenderit është bërë me datën e njejtë duke filluar në ora **14:00**. Njoftimin e parë për dhënie të kontratës e kemi marrë në njoftimin për dhënie të kontratës me të cilin jemi rekomanduar për kontratë me datën **14.01.2026** ora **13:10** Njoftimin e dytë si tenderues i pasuksesshëm pas rivlerësimit e kemi marrë në vendimin e AK-s B58 të publikuar me datë **26.03.2026** ora **15:27**. Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë tendei i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim për dhënien e kontratës e kemi pranuar me datën: **31.03.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Nuk kemi marrë pjesë në hapjen e tenderit, por me qenë se procesverbali na është dërguar përmes platformës elektronike nuk kemi pasur ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

Njoftimin si tenderues i eliminuar e kemi marrë në vendimin e AK-s B58 të publikuar me datë **26.03.2026**

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Autoriteti Kontraktues-Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 26.03.2026 ka publikuar dokumentin B58 me të cilën ka vendosur që të shpërblen me kontratë operatorin ekonomik WOOD CORPORATION L.L.C. kurse neve me letren standarde na ka cilësuar si tenderues të pa përgjegjshëm për tenderin në fjalë.

Të pa kënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblim me kontratë të një O.E. të pa përgjegjshëm si dhe me vlerësimin jo të drejtë të tenderit në fjalë, duke u bazuar në nenin 10 të LPP-s kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik me ç'rast AK na ka dhënë qasje në dokumentet e kërkuara nga të cilat kemi vërejtur që O.E. i propozuar për kontratë ka dorëzuar tender të pa përgjegjshëm.

Duke u bazuar në nenin 108A të LPP-s, kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim të vendimit të AK-s, në të cilin kemi cekur se me rastin e vendimit Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-s të rregulluara me Nenin 1; 6; 7; 28; 59 dhe 60 të LPP-së .

Gjithashtu me kërkesën tonë, Duke u bazuar në nenin 108 A të LPP-s paragrafi 2, si dhe në rrethanat, faktet dhe dëshmitë dorëzuara me kërkesën për rishqyrtim, kemi kërkuar nga AK që automatikisht të pezullon zbatimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë dhe qe te merr:

V E N D I M

- **Të aprovet** kjo Kërkesë për Rishqyrtim si tërësisht e **bazuar**.
- **Të anulohet Njoftimi** mbi Vendimin e AK-së i datës 26.03.2026.

- **Të bëhet rivlerësimi** i ofertave në mënyrë objektive, duke eliminuar ofertën e papërgjegjshme të OE "WOOD CORPORATION L.L.C" (për shkak të dështimit në përmbushjen e specifikimeve teknike) dhe duke rekomanduar për kontratë operatorin tonë si ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Gjithashtu e kemi paralajmëruar AK-n që në rast se dështon në marrjen e një vendimi të drejtë dhe meritore brenda afateve ligjore, ne do të jemi të detyruar që, në mbrojtje të interesave tona legjitime, ta përcjellim lëndën për shqyrtim në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe sipas nevojës, të iniciojmë procedurat pranë organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit për të adresuar çdo dyshim mbi keqpërdorimin e fondeve publike.

Mirëpo AK duke mos i marrë parasysh provat dhe faktet e paraqitura në kërkesën tonë me datën 31.03.2026 e refuzon kërkesën tonë për rishqyrtim në kundërshtim me dispozitat ligjore të legjislacionit të prokurimit, duke mos i marrë për bazë vërejtjet dhe faktet të cilat tregojnë se janë shkelur dispozitat ligjore të cekura në kërkesën për rishqyrtim pa dhënë ndonjë arësyetim të bazuar dhe pa i shqyrtuar disa nga pretendimet tona të cilat janë dokumentuar me anë të fakteve dhe provave.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë me nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 mendojmë që Autoriteti kontraktues i ka shkelur dispozitat e LPP-së si në vijim:

- **Është shkel neni 1 i LPP-së (Qëllimi)**
- **Është shkel neni 6 i LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)**
- **Është shkel neni 7 i LPP-së (Barazia në trajtim/Jo diskriminimi)**
- **Është shkel neni 28 i LPP-së (Specifikimet teknike)**

- **Është shkel neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)**

- **Është shkel neni 60 i LPP-së (Kriteret e dhënies së Kontratës)**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues ka shpallur tenderin në fjalë në të cilin ka paraqitur kërkesat për pjesëmarrje si dhe ka paraqitur kriterin për dhënie i cili ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ndërsa ne si Operator Ekonomik i jemi përgjigjur ftesës së tyre për tender duke e përgaditur tenderin dhe duke ia bashkangitur të gjitha dokumentet e kerkuara nga ana e AK-s.

Pasi na është refuzuar tenderi jonë në mbështetje të Nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Operatori Ekonomik "Mobelland", brenda afatit ligjor, ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 26.03.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Inventar per Salla te gjykimeve dhe Zyra te Shkrimoreve per Gjykata dhe KGJK" me nr. të prokurimit: "328-25-10983-5-5-8".

Përmes njoftimit të lartcekur, Autoriteti Kontraktues (AK) ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik "WOOD CORPORATION L.L.C", ndërsa ofertën tonë e ka eliminuar si të papërgjegjshme. Ky vendim vjen pas procesit të rivlerësimit të urdhëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), proces në të cilin AK ka dështuar të veprojë në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe kriteret e dosjes së tenderit.

Ne shprehim pakënaqësinë tonë të thellë ndaj këtij vendimi, duke konsideruar se eliminimi i ofertës sonë e cila ishte vlerësuar paraprakisht si e përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët është bërë në mënyrë arbitrare dhe pa asnjë arsytim valid ligjor. Ky veprim i AK-së, përveç se shkel rëndë parimet bazë të prokurimit publik siç janë transparenca, barazia dhe mos-diskriminimi, dëmton drejtpërdrejt buxhetin e Republikës së Kosovës duke favorizuar një ofertë me çmim dukshëm më të lartë. Konsiderojmë se komisioni i vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit kanë tejkaluar autorizimet e tyre, duke nxjerrë një vendim që ngre dyshime serioze për trajtim jo-meritor të ofertuesve. Në vijim, po paraqesim pretendimet tona ankimore të detajuara, duke argumentuar shkeljet procedurale dhe ligjore të kryera gjatë procesit të rivlerësimit.

Pretendimi i pare ankimor.

Pretendojmë që AK ka bërë shkelje të Nenit 1, Nenit 59 dhe Nenit 116.6 të LPP-së. Mungesa e arsytimit ligjor dhe keqinterpretimi i vendimit të OSHP-së.

Në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) të datës 26.03.2026, oferta jonë është eliminuar me një arsytim krejtësisht të mangët dhe të pabazuar, duke u mjaftuar vetëm me referencën ndaj vendimit të OSHP-së nr. 2026/0068. Ky veprim i AK-së përbën shkelje ligjore dhe procedurale për pikat vijuese. Interpretimi i gabuar i Nenit 116, pika 6 të LPP-së. AK ka dështuar të zbatojë korrektësisht nenin 116.6 të LPP-së, i cili specifikon qartë se:

"Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim nuk nënkupton një ndryshim në rezultatit fillestar".

Vendimi i OSHP-së nuk e ka shpallur ofertën tonë të papërgjegjshme, ai thjesht ka obliguar AK-në që të sqarojë dhe elaborojë procesin e vlerësimit të parë. AK, në vend që të përmirësonte arsytimin e tij, ka zgjedhur rrugën më të lehtë (dhe të kundërligjshme) të eliminimit të ofertës sonë, duke e keqpërdorur vendimin e OSHP-së si mburojë për ndryshimin e fituesit pa asnjë bazë të re faktike.

Konfuzioni i AK-së mes "Imazhit Ilustrues" dhe "Variantit Teknik". Pretendimi i heshtur i AK-së (i derivuar nga procesi në OSHP) se oferta jonë përmban "variante" është teknikisht dhe ligjorisht i paqëndrueshëm.

Fakti është se në katalogun tonë për pozicionet 9, 10, 12, 13, 14, 16 dhe 21 për secilin pozicion të caktuar, kemi paraqitur vetëm një (1) specifikim teknik unik por që kemi ofruar foto të cilat e

plotësojnë në plotni specifikën teknike të paraqitur nga ana jonë.

Argumenti është se prezantimi i **dy apo më shumë fotografive** për të njëjtin pozicion produkt shërben vetëm për ilustrim vizual të artikullit nga nuanca të ndryshme dhe nuk përbën "**variant**". Sipas rregullave të prokurimit, variant teknik do të konsiderohej vetëm nëse do të **ofroheshin parametra teknik të ndryshëm** (p.sh. fuqi, dimensione apo materiale të ndryshme) për të njëjtin produkt (artikull) të një pozicioni. Në rastin tonë, specifikimi teknik mbetet një edhe i pandryshuar për secilin pozicion.

Shkelja e parimit të shfrytëzimit efikas të fondeve publike (Neni 1 i LPP-së). Me eliminimin e ofertës sonë e cila është dukshëm më e lirë për shkak të një keqkuptimi lidhur me fotografitë në katalog, bie ndesh me nenin 1 të LPP-së. AK ka pasur obligim ligjor që, në rast paqartësie, të kërkojë sqarim sipas Nenit 72 të LPP-së, para se të ndërmerre hapin ekstrem të eliminimit. Duke **favorizuar një ofertë me çmim më të lartë** pa asnjë një bazë ligjore, AK ka dëmtuar drejtpërdrejt buxhetin e shtetit që është shkelje e rëndë në procedurat e prokurimit.

Oferta jonë është e përgjegjshme për këtë pikë sepse ajo përmbush të gjitha kriteret teknike dhe ofron vlerën më të mirë për parane publike me çmimin më të ulët.

Pretendimi i dytë ankimor.

Pretendojmë se AK ka bere shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit (Neni 7), Ekonomicitetit dhe efikasitetit (Neni 6), si dhe vlerësimi i gabuar i ofertave (Neni 59, 60 dhe 61 i LPP-së). Në procesin e rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në mënyrë arbitrare duke eliminuar ofertën tonë pa kryer një analizë të mirëfilltë dhe të pavarur, duke u mjaftuar me referimin në vendimin e OSHP-së.

Arsyetimi mbi çmimet e pretenduara si "të larta" (Pozicionet 9 dhe 39). AK ka konsideruar çmimet për pozicionin 9 Karrige për gjyqtarë 200 € dhe pozicionin 39 Karrige për publikun 210 € si më të larta se tregu. Ky konstatim është i pabazuar për arsyet se këto çmime janë në përputhje të plotë me **specifikimet teknike** të kërkuara në Dosjen e Tenderit. Cilësia dhe parametrat e kërkuar diktojnë këtë kosto dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme edhe në treg. Karriga për gjyqtar dhe ajo për publikun në **salle** është çmimi mesatar 200-210 € në treg, ato sillen në treg edhe deri 400 € e më lartë. Duke pasur parasysh paramasat dhe dimensionet specifike të karriges të cilat janë kërkuar me dimensionet e lartësisë prej 136 cm është e pamundur që në treg të gjendet karrige me çmim nën 200.00 €. AK ka mundur që para se ta cilëson këtë çmim si jo normalisht të ulët të hulumton tregun dhe do të ishte bindur që çmimi i dhënë nga ana jonë është çmim real i tregut. Ndërsa sa i përket karriges për sallë të gjykimeve, kjo karrige ka specifika të veçanta pasi që është paraparë që të montohen dhe ankerohen në dysheme me pajisje adekuate të cilat kërkojnë një staf të specializuar për tu montuar me një kujdes të veçantë pasi që në dysheme janë të vendosura gypa të ndryshëm të ngrohjes qendrore si dhe atyre të energjisë elektrike. Andaj të gjitha këto paraqesin një kosto shtesë të cilat e rrisin çmimin e artikullit në fjalë.

Ne kemi bashkëpunuar me autoritetin kontraktues në fjalë, pasi që kemi realizuar disa kontrata me artikuj të njëjtë të cilat i kemi realizuar me përpikmëri duke ju përmbajtur specifikacionit teknik dhe nuk kemi pasur asnjë vërejtje sa i përket kualitetit dhe specifikave teknike por përkundër kësaj ne jemi pajisur me referencë pozitive e cila dëshmonë kryerjen e furnizimeve në mënyrë profesionale dhe duke respektuar afatet e përcaktuara në kontratë. Gjatë vlerësimit të parë, ne kemi ofruar dëshmi dhe sqarime shtesë me të cilat AK ishte pajtuar plotësisht. Ndryshimi i qëndrimit në rivlerësim, pa asnjë analizë të re të tregut nga ana e AK-së, përbën vlerësim jo-objektiv dhe te hapur tendencioz.

Ne vijim arsyetimi yne mbi çmimet e pretenduara si "jo-normalisht të ulëta" (Neni 61 i LPP-së)

Për pozicionet 2, 8, 14, 40 dhe 4. AK gabon kur i cilëson si jo-normalisht të ulëta sepse ka pasur kontrata me këto çmime të njëjta, ne kemi furnizuar AK-në përgjatë një kontrate paraprake tri-vjeçare pa asnjë vërejtje në cilësi apo dërgesa. Kjo dëshmon se këto çmime janë të qëndrueshme dhe produkt i politikave tona tregtare dhe ekonomisë së tregut. AK ka shkelur Nenin 61 të LPP-së, pasi nuk ka kërkuar sqarim specifik për këto çmime në fazën e rivlerësimit, por ka kaluar direkt në eliminim, duke na mohuar të drejtën për të dëshmuar përgjegjshmërinë e çmimeve tona. AK bene trajtim diskriminues dhe standardet e dyfishta (Neni 7 i LPP-së) sepse derisa oferta jonë eliminohet për "paqëndrueshmëri çmimesh", AK ka rekomanduar për kontratë një Operator Ekonomik (OE) që ka paraqitur çmime haptazi manipuluese dhe jologjike. Si shembull OE i rekomanduar ka ofruar "Vitrinë me 6 dyer" (poz. 20) me çmim **84.00 €**, ndërsa "Vitrinë me 4 dyer" (poz. 21) me çmim **184.90 €**. Është logjikisht dhe teknikisht e pamundur që produkti më i madh të kushtojë më pak se gjysma e produktit më të vogël. Sipas kesaj logjike te AK, ky është indikator i pastër i manipulimit me çmime, të cilin AK e ka injoruar te OE fitues, duke aplikuar kritere diskriminuese vetëm ndaj nesh. AK ka bere shkelje të nenit 6 të LPP (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) duke eliminuar ofertën tonë që është **dukshem më e lirë** në totalin e saj. AK ka dështuar të mbrojë interesin publik dhe buxhetin e Kosovës. Përzgjedhja e një oferte më të shtrenjtë, duke ngritur anomali të pa qena në çmime për njësi, bie ndesh me qëllimin kryesor të LPP-së për shfrytëzimin efikas të fondeve publike. AK duhet të analizojë këto mospërputhje, të vlerësojë ofertat në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me kriterin e dhenies se kontrates per çmim më të ulët i dhene ne Nenin 60 të LPP-së.

Pretendimi i tretë ankimor.

Pretendojm se AK ka bere shkelje te Nenit 59, pika 4 dhe Nenit 28 të LPP-së mosplotësimi i specifikimeve teknike të detyrueshme për Pozicionin 10.

Pas realizimit të të drejtës sonë ligjore për qasje në dokumentacionin e ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, kemi konstatuar se kjo ofertë është teknikisht e papërgjegjshme, pasi dështon të përmbushë kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit (DT) për artikullin në Pozicionin 10 "Karrige lëvizëse për zyrtarë të lartë".

Diferenca mes kërkesës teknike dhe produktit të ofruar sipas specifikimit teknik të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në DT, ku kërkohet në mënyrë taksative që karrigia të ketë:

Shtyllë mbajtëse pesë-cepëshe të punuar nga çeliku i kromuar, Rrota të punuara nga topat e çelikut. Ndërsa në katalogun e dorëzuar nga OE i rekomanduar, dëshmohet qartë (përmes fotografive dhe përshkrimit teknik) se produkti i ofruar ka bazamentin (shtyllën mbajtëse) dhe rrotat të punuara tërësisht nga materiali plastikë.

Për të vërtetuar këtë mospërputhje, ne kemi siguruar specifikimin teknik direkt nga furnizuesi i këtyre produkteve në tregun e Kosovës, ku konfirmohet se modeli i ofruar nga OE fitues nuk prodhohet me elemente çeliku të kromuar siç kërkohet, por vetëm me komponentë plastike. Bashkëngjitur kësaj kërkesë, po paraqesim fotografinë e nxjerrë nga katalogu i OE-së fitues dhe fletë-specifikimin e prodhuesit që vërtetojnë devijimin esencial nga kriteret e DT-së.

Neni 59, pika 4 e LPP-së, e obligon Autoritetin Kontraktues që të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ofertat që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale duhet të eliminohen automatikisht.

Në këtë rast, AK ka aplikuar standarde të dyfishta, ka eliminuar ofertën tonë (më të lirën) pa asnjë bazë teknike, ndërsa ka shpallur fitues një OE që ka devijim substancial nga specifikimet teknike të kërkuara. Shih foton e artikullit nr.10 me përshkrim teknik.

10

Karrika lëvizëse për Zyrtar te lart

Kërriga lëvizëse me rrota, te mbështetura në një shtyllë mbajtëse me podest pesë cepësh i punuar nga çeliku i kromuar. Për lëvizje më të lehtë rrotat në brendi janë nga tophi i çelikut i mbështetur në kunj të çeliktë kurse mbështjellja e tyre është nga materiali lëkurës ngjyrë te zeze, karriget janë të përshatshme për lëvizje në dysheme nga tepisoni dhe të kenë veti antistatike. Karriga posedon të instaluar mekanizmin për rregullimin e lartësisë së uljes e cila duhet të sillet prej 45-52cm, si dhe mundësinë e fiksimit në lartësinë e dëshiruar, gjithashtu posedon të instaluar edhe dorëzën për manipulim në krye të shtyllës mbajtëse. Mbështetësja e shpinës dhe ulësja janë të mbushura me shpuzë poliuretani me densitet 40 rc në ulëse, dhe 30 rc në mbështetëse të mbështjella me shtresë të butë përfundimtare. Lartësia e mbështetëses së shpinës është mbi 60cm dhe ka mundësinë e rregullimit të pozitës në kënde të ndryshme. Mbështetëset e krahëve janë nga druri gjysme të mbështjella. Mbështjellësi është nga lëkura me ngjyrë të zezë. Karriga posedon mekanizmin për lëvizje, në shpinë dhe ulëse si dhe amortizuesin për ngritje dhe ulje deri 9cm, Këmbët i ka nga hekuri i mbështjellë me dru, Dimensionet e ulëses janë 51-47cm Dimensionet e shpinës janë 51-66cm

Ngjyrat dhe modelet mund të përcaktohen nga AK.



Sikur shihet nga specifikat teknike të lartcekura karrigia e ofruar nga O.E. i rekomanduar nuk i plotëson specifikat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues për këtë karrige pasi që: 1. Lëkura e karriges nuk është ngjyrë e zezë sikur është kërkuar në nga AK por sikur shihet ka ngjyrë kafe. 2. Nuk është e punuar nga çeliku i kromuar por nga plastika. 3. Këmbët nuk i ka nga hekuri i mbështjellur me dru por është ofruar një karrigë me këmbë të plastikës së dobët. 4. Rrotat nuk i ka nga topha çeliku sikur është kërkuar nga Ak por është ofruar një karrige me rota të thjeshta të plastikës.

Ky lloj i karriges të cilën e ka ofruar O.E. i rekomanduar vërteton që nuk i përmban specifikat e kërkuara, më poshtë kemi bashkangjitur specifikat që i posedon një karrige e tillë e cila shihet qartë që nuk i përmbush specifikat teknike të kërkuara nga ana e AK-s. Ky fakt mbështetet edhe në dëshmi bindëse sikur është DUD-i doganor për furnizimin me këtë lloj të karriges. Shih më poshtë foton dhe krahaso specifikat origjinale të karriges së ofruar me ato të kërkuara nga ana e Autoritetit Kontraktues.



Z OFFICE SH.P.K

Adresa: Prishtin Rr ISUF GERVALLA Nr28

Tel: +38344 117 105, +38346900001

E-mail: zoffice.ks@gmail.com

Numri unik identifikues 811891185



SPECIFIKIM TEKNIK – KARRIGE ZYRE PROFESIONALE

Kjo karrige zyre është projektuar për të ofruar rehati maksimale, funksionalitet të lartë dhe qëndrueshmëri në përdorim të përditshëm në ambiente pune.

Karakteristikat kryesore:

- Përmasat:
- Gjerësia: 53 cm
- Thellësia: 56 cm
- Lartësia e rregullueshme: 110 – 120 cm
- Mekanizmi i rregullimit:
- E pajisur me mekanizëm ngritje/uljeje me piston gazi (gas lift) për përshtatje ergonomike sipas përdoruesit
- Funksion lëkundjeje dhe mbështetje për shpinën (tilt mechanism) për rehati gjatë përdorimit të zgjatur
- Mbështetëset e krahëve:
- Të prodhuara nga plastikë rezistente
- Të veshura me material cilësor (lëkurë artificiale) për komoditet shtesë
- Baza dhe stabiliteti:
- Bazë në formë ylli të plastikes me 5 këmbë (5-point base) për stabilitet maksimal
- E ndërtuar nga plastikë e fortë dhe rezistente ndaj konsumit
- Rrota të Plastikes të integruara për lëvizje të lehtë dhe të qetë
- Materiali dhe ndërtimi:
- Ulësja dhe mbështetësja janë të mbushura me sfungjer me densitet të lartë për rehati optimale
- E veshur me lëkurë artificiale cilësore, e lehtë për mirëmbajtje dhe pastrim

Data 01-12-2025



2 Eksportuesi Nr FOSHAN HONYSHINESUM TRADING CO.,LTD CHINA		1 DEKLARATË IM 4		2048 DURRËS KONTEINER Referenca doganore	
8 Marrësi / Importuesi Nr 811891185 Z Office SH.P.K. Astrazup, Rruga Rilindja Kombëtare, Malishevë		3 4 1 4 Manifesti		R 19385 26/08/2025	
14 Deklaruesi Nr 810989113 N.T.SH. "ALB - KOS R" TRANZITI PN. Prizren		5 Emërtimi 10		6 Nr. pakove 484	
18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në 04851HB 04411TA XK yes		9 Personi përgjegjës Nr 811891185 Z Office SH.P.K. Astrazup, Rruga Rilindja Kombëtare, Malishevë		7 Numri referues 2025 #21	
21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon 04851HB 04411TA XK		10 Vend. XK nga AL ct.		11 Vendi i AL ct.	
25 Lloji 30 në kufi		26 Lloji 30 Transport		12 Detajet e vlerës 4,990.30	
29 Zyra doganore hyrëse/dalëse AL14 DURRËS KONTEINER		30 Lokacioni i mallrave		13 P.P.B 0	
		15 Vendi dërgues/eksportues KINA		15 V.E. Kodi a CN b	
		16 Vendi origjinës KINA		17 V.D. Rajoni a XK b	
		19		17 Vendi i destinacionit KOSOVA	
		20 Kushtet e dërgesës FOB KINA-CN			
		22 Valuta dhe shuma e USD 8,923.00		23 Kursi i 0.8614748	
		27 Transportuesi		24 Lloji i 1 1 transaks.	
		28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e			

PËRFUNDIMI I ANKESËS

Mbështetur në të gjitha argumentet e elaboruara më lart, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka kryer shkelje substanciale të procedurave gjatë procesit të rivlerësimit. Ne i kemi bërë thirrje AK-së që të reflektojë mbi këto pretendime të bazuara dhe të mbrojë vendimin e tij fillestar, i cili ishte i drejtë, profesional dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së, duke na konfirmuar si Operator Ekonomik të përgjegjshëm me ofertën më Çmim me te ulët sipas kriterit për dhenie të kontrates në dosjen se tenderit.

Pas vlerësimit të parë dhe rekomandimit, AK neve na ka konsideruar të përgjegjshëm duke na rekomanduar për kontratë me dokumentet dhe specifikat e njejta të dorëzuara me tenderin tonë. Gjithashtu nuk janë pajtuar me pretendimet e O.E. të rekomanduar pas kërkesës për rishqyrtim pasi që shihet qartë që nuk ka pasur bazë asnjëri pretendim i tij. Gjithashtu edhe pas shqyrtimit AK është pajtuar plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues i cili i ka cilësuar si të pa baza të gjitha pretendimet e O.E. ankues.

Nga AK si monitorues, zhvillues dhe mbrojtës i sistemit të drejtësisë i cili është i obliguar që të reagoj ndaj padrejtësive dhe të mbroj palët të cilave i shkelen të drejtat, kemi kërkuar që të reagoj ndaj padrejtësisë që po na bëhet vazhdimisht në tenderët në të cilët kemi konkuruar. Gjithashtu kemi kërkuar që të merren masa për korrigjimin e këtyre shkeljeve përndryshe do të detyrohemi që t'i drejtohem organeve përgjegjëse të drejtësisë duke kërkuar të drejtën tonë pa u ndalur deri në vënien para drjetësisë të personave përgjegjës.

Kompania jonë mbetet plotësisht e hapur që, në mbështetje të Nenit 72 të LPP-së, të ofrojmë sqarime shtesë lidhur me çdo paqartësi të pretenduar mbi "variantet" apo strukturën e çmimeve edhe pse te njejta i elaboruam me larte mjaftë qarte.

Duke analizuar dhe parë dosjen e tenderit konsiderojmë që ne i kemi plotësuar të gjitha kriteret e

kërkuara dhe mendojmë që në vendimin e OSHP-së nr. 2026/0068 nuk janë marrë për bazë specifikat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues. Mendojmë që edhe paneli me siguri ka bërë ndonjë gabim teknik dhe duke mos e zbatuar legjislacionin e prokurimit kur ka konstatuar që ne kemi ofruar variant për shkak se kemi ofruar disa foto për një artikull me specifika teknike dhe me këtë neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme të konsiderueshme. Andaj kërkojmë nga ana e OSHP-s që këtë ankesë ta trajtojë me kujdes të veçantë dhe të merr për bazë provat dhe faktet tona në mënyrë që të bëhet një vlerësim i drejtë dhe meritore në lidhje me ankesën tonë.

Ne ri-theksojmë se çmimet tona janë të balancuara, reflektojnë kushtet e tregut të lirë në Kosovë dhe garantojnë ekzekutimin e suksesshëm të kontratës pa asnjë rrezik për AK-në.

Bazuar në ato që u shpjeguan më lartë, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të nxjerrë këtë:

- **Të aprovohet** kjo Ankesë si tërësisht e **bazuar**.
- **Të anulohet Njoftimi** mbi Vendimin e AK-së i datës 26.03.2026.
- **Të bëhet rivlerësimi** i ofertave në mënyrë objektive, duke eliminuar ofertën e papërgjegjshme të OE "WOOD CORPORATION L.L.C" (për shkak të dështimit në përmbushjen e specifikimeve teknike) dhe duke rekomanduar për kontratë operatorin tonë si ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke pasur parasysh shkeljet të cilat i ka bërë Autoriteti Kontraktues si më lartë, neve do të na shkaktohen dëme materiale sepse për përgatitjen e tenderit janë bërë shpenzime të konsiderueshme si dhe fitimi i humbur rreth **50.000 €** për shkak se ne kemi ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët në mesin e tenderuesve të përgjegjshëm.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrë më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*